



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I FINANCES

Nr. 2807 prot

Ballsh, më 10 / 06 2024

PROJEKT VENDIM

Nr. 21 Datë 10 / 06 2024

PËR RISHPËRNDARJE TË FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2024

Mbeshtetur ne nenet 34,40,41, 55 te ligjit Nr 139/2015 "Per Vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr 9936 date 26-08-2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 te ligjit Nr 68/2017 "Per Financat e Vetqeverisjes Vendore", Ligjin Nr 97/2023 "Per Buxhetin e Vitit 2024" ligjin Nr 10296 date 08-07-2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", si dhe shkresës me nr. 1815/3 prot. datë 11.03.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me lëndë "Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin" dhe sipas shkresës se ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit programi buxhetor është 09230 kryetari i Bashkisë, i propozon këshillit te Bashkise Mallakaster:

TË MIRATOJ

1. Të bëhet rishpërndarja e fondeve buxhetore viti 2024 si më poshtë

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Shuma	Emërtimi i projektit	Kod projekti
PAKESOHET								
131	00	2131001	05	09120	2310000	17.000.000	Ndërtim i shkollës "Gjok Doçi	1310351
131	00	2131001	05	09120	2310000	2.968.745	Mbikqyrje punimesh në objektin "Ndërtim i shkollës "Gjok Doçi	1310457
SHUMA						19.968.745		
SHTOHET								
131	00	2131001	05	09230	2310000	17.000.000	Ndërtim i shkollës "Gjok Doçi	1310351
131	00	2131001	05	09230	2310000	2.968.745	Mbikqyrje punimesh në objektin "Ndërtim i shkollës "Gjok Doçi	1310457
SHUMA						19.968.745		

Drejtori Drejtorise Ekonomike **Aleksander Rama**

Drejtor i D.B.Nj.J. **Laureta Saliaj**

KRYETAR
Qerim ISMAILAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I FINANCES

Nr. 2807/11 prot

Ballsh, më 10/06 2024

RELACION
PËR

PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2024.

Bashkia Mallakastër pas aplikimit për projektet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për objektet shkollorë është shpallur fitues për projektin “Ndërtim i shkollës Gjok Doçi”. Sipas shkresës me nr.1815/3 prot. datë 11.03.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me lëndë “ Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit hde Sportit,për objekte shkollorë të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin”, vlera totale e projektit të këtij objekti është 190.613.399 (Njëqind e nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë ,e ndarë në financim në 2(dy) vite 2024 dhe 2025 .

Financimi i këtij projekti do të bëhet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në shumën **162.021.389** (Njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e njëzetë një mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë e ndarë në 2 (dy) vite:

Dhe nga buxheti i Bashkisë Mallakastër në shumën **28.592.010** (Njëzetë e tetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë dy mijë e dhjetë) lekë,e ndarë në dy vite: .

Në buxhetin e vitit 2024 pjesa takuese e bashkisë Mallakastër si për investimin ashtu dhe për mbikqyrjen e punimeve të objektit “Ndërtim i shkollës Gjok Doçi”, janë planifikuar nga programi ekonomik 09120 (Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor) .

Për shkak se fondet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë celur në programin 09230 (Arsim i mesëm i përgjithshëm),duhet të bëjmë ndryshimin e programeve buxhetore për vitin 2024 për mbulimin me fonde të investimit nga programi buxhetor 09120 (Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor) në programin buxhetor 09230(Arsim i mesëm i përgjithshëm),për këtë arsye bëhen rishperndarja e mëposhtëme

- Pakësohet me 17.000.000 lekë Programi buxhetor **09120** (Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor) **Nërtim i shkollës Gjok Doçi** me kod projekti 1310351
- Shtohet me 17.000.000 lekë Programi buxhetor **09230** (Arsim i mesëm i përgjithshëm) **Nërtim i shkollës Gjok Doçi** me kod projekti 1310351

Për mbikqyrjen e punimeve në objektin : “Ndërtim i shkollës Gjok Doçi me kod projekti 1310457 :

- Pakësohet me 2.968.745 lekë Programi buxhetor **09120** (Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor) me kod projekti 1310457
- Shtohet me 2.968.745 lekë Programi buxhetor **09230** (Arsim i mesëm i përgjithshëm) me kod projekti 1310457

Drejtori Drejtorise Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale
Aleksander Rama

KRYETAR

Qerim ISMAILAJ

